



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Drejtuar: **ORGANEVE TË SISTEMIT TË DREJTËSISË**
MINISTRISË SË DREJTËSISË

Sot, më datë 21.12.2023, Ne, Asambleja e Përgjithshme e Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë, që jemi organi më i lartë i përfaqësimit dhe vendimmarrjes së kësaj organizate juridike, vendosëm t'i drejtohem të gjitha organeve të Sistemit të Drejtësisë në vend dhe Ministrisë së Drejtësisë.

Në kompetencat që na jep ligji dhe Statuti i Dhomës, zgjedhim dhe shkarkojmë, organet drejtuese të Dhomës, kujdesemi për mbarëvajtjen e veprimtarisë së Shërbimit Përmbauesor Gjyqësor Privat dhe vendosim për politikën e përgjithshme të Dhomës.

Dhoma përfaqësohet nga Kryetari i Dhomës, z. Tedi Malaveci, të cilin e kemi zgjedhur nga radhët tona, në datë 24.09.2022 për një mandat 4- vjeçar, me vullnet të lirë dhe votim të rregullt. Është i njëjti përmbaues i cili ka ushtruar këtë rol drejtues, i zgjedhur prej nesh për dy mandate të tjera, (2014-2022).

Kryetari i Dhomës ka përfaqësuar dhe vijon të përfaqësojë më së miri interesat e gjithë përmbauesve anëtarë të Asamblesë së Përgjithshme, përpara pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe atij gjyqësor në vend, përfshirë organizatat, institucionet publike private, vendase dhe ndërkombëtare.

Kryetari i Dhomës ka paraqitur mendimin dhe vullnetin e Dhomës në lidhje me të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore që janë propozuar për miratim por dhe që janë kundërshtuar në shkallët e gjyqësorit, për rregullimin e veprimtarisë së trupës së përmbauesve gjyqësorë privatë.

Veçanërisht vullneti i Dhomës është paraqitur nëpërmjet Kryetarit të saj, kur ka përfaqësuar Dhomën në Gjykatën Administrative të Apelit, Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese, në mbrojtje të Udhëzimit të përbashkët nr. 385/7, datë 28.6.2017 "*Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbauesor gjyqësor privat*". Është rasti të autorizojmë Kryetarin të vijojë të ndjekë me ankim në Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut vendimin e fundit të Gjykatës Kushtetuese nr. 49, datë 16.10.2023.

Ne do refuzojmë dhe do godasim ligjërisht çdo individ, ent publik apo privat që vendos në diskutim vullnetin tonë për të zgjedhur drejtuesit tanë dhe që do anatemojnë punën e tyre, sa kohë i kemi deleguar autoritetin tonë për të përfaqësuar interesat e përmbauesit gjyqësor privat brenda dhe jashtë vendit.

Çdo goditje e natyrës gjyqësore dhe mediatike e autoritetit të Kryetarit të Dhomës dhe organeve të tjera drejtuese të zgjedhura prej nesh, pas zgjedhjes së tyre në datë 24.09.2022 dhe sot më 21.12.2023, do konsiderohet goditje ndaj Dhomës dhe do marrë përgjigje të menjëhershme ligjore, para gjithë organeve të sistemit të drejtësisë në vend dhe publikut të gjerë.